

AMF dhe Universiteti Mesdhetar në Tiranë bashkëpunojnë për të rritur edukimin financiar tek studentët

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2017

Zhvillime të tjera

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paralajmëron për rrezikun e investimit në emetimet e monedhave virtuale me ofertë fillestare ose të ashtuquajturat ICO
- Zhvillohet Konferenca e 24-të Vjetore e IAIS me temë “Mbikëqyrja në sigurime: vështrim më i gjerë”
- Kolegji i Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA i Autoritetit Austriak të Tregut Financiar zhvillon mbledhje dyditore
- Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Formimi Profesional Financiar – e tashmja dhe e ardhmja”
- Workshop “Mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”
- Kolegji i Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group zhvillon mbledhje dyditore

Edukimi i Konsumatorit

- Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm

Lajme Ndërkombëtare

- Estoni
- Kosovë
- Kroaci
- Lituani
- Rusi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF dhe Universiteti Mesdhetar në Tiranë bashkëpunojnë për të rritur edukimin financiar tek studentët

Autoriteti ka marrë një iniciativë për të rritur edukimin financiar duke e nisur këtë me studentët si një nga target grupet më të rëndësishme në zhvillimin e vendit. Qëllimi ynë është që të rinjtë të njohin Autoritetin, tregjet që ai mbikëqyr, në mënyrë që më pas t'i përdorin njohuritë e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, duke qenë aktorë të rëndësishëm të tregjeve financiare - theksoi Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Z. Nexhmi Dumani, si dhe Prof. Dr. Anastas Angjeli, president i UMSH-së gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 8 nëntor një takim informues me studentët e Fakultetit të Shkencave Ekonomike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, në vijim të zbatimit të Strategjisë për “Rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”. Aktiviteti synoi rritjen e njohurive dhe edukimin financiar të të rinjve për Autoritetin, fushën e tij të veprimtarisë dhe tregjet financiare nën mbikëqyrje. Gjatë aktivitetit u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Z. Nexhmi Dumani, në prani të presidentit të UMSH-së, Prof. Dr. Anastas Angjeli.

Në fjalën e rastit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi theksoi se “Autoriteti ka marrë një iniciativë për të rritur edukimin financiar duke e nisur këtë me studentët si një nga target grupet më të rëndësishme në zhvillimin e vendit. Qëllimi ynë është që të rinjtë të njohin Autoritetin, tregjet që ai mbikëqyr, në mënyrë që më pas t'i përdorin njohuritë e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, duke qenë aktorë të rëndësishëm të tregjeve financiare.”

Nga ana e tij, presidenti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Z. Anastas Angjeli theksoi se “marrëveshja do të shërbejë jo thjesht për të shkëmbyer eksperiencën, por edhe për të përfituar praktikë mësimore nga studentët pranë AMF-së.” Sipas tij, “marrëveshja ka në thelb shkëmbimin e informacionit, zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, konferencave, për rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që do të sjellë përfitime reciproke, si për stafin e universitetit, studentët dhe pedagogët, ashtu edhe për vetë Autoritetin, me qëllim rritjen e informacionit financiar”.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të fushatës ndërgjegjësuese që AMF ka nisur për edukimin financiar në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informacionit në funksion të mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, por edhe zhvillimit të mëtejshëm të këtyre tregjeve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-tetor 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-tetor 2017 kapën vlerën mbi 13.08 miliardë lekë, ose 8.92% më shumë se gjatë periudhës janar-tetor 2016. Gjatë periudhës janar-tetor 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,042,340 me një rritje prej 15.32% krahasuar me periudhën janar-tetor 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 15.80% në krahasim me periudhën janar-tetor 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 4.01 miliardë lekë, apo 15.80% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 7.61% gjatë periudhës janar-tetor 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-tetor 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 8.12 miliardë lekë gjatë periudhës janar-tetor 2017, duke shënuar një rritje prej 8.59% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.12% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

■ Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 11.04% të tregut të Jo-Jetës;

■ Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 12.58% të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rriten me 28.50% krahasuar me periudhën janar-tetor 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitor” e cila përbën 64.26% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 7.38 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2017, duke shënuar një rritje prej 11.06% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paralajmëron për rrezikun e investimit në emetimet e monedhave virtuale me ofertë fillestare ose të ashtuquajturat ICO



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon investitorin se në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston asnjë kompani e licencuar nga Autoriteti për të emetuar monedha virtuale me ofertë fillestare.

Kohët e fundit, në nivel evropian dhe global, shumë kompani po mbledhin para nga publiku duke përdorur një mekanizëm të ri, emetimin e Monedhave Virtuale me Ofertë Fillestare ose të ashtuquajturat ICO. Sipas këtij mekanizmi apo kësaj alternative të re të financimit të biznesit, kryesisht të projekteve të reja, investitorët në këmbim të parave, ose në këmbim të monedhave virtuale të tjera si për shembull Bitcoin dhe Ether, marrin nga kompanitë emetuese një monedhë virtuale, që mund të njihet si “token”, e specifikuar nga kompania apo projekti përkatës dhe që përfaqëson pjesëmarrje në të ardhurat e kompanisë që nuk janë realizuar akoma.

Emetimi i monedhave virtuale me ofertë fillestare ICO, si rregull nuk është subjekt i ndonjë forme rregullimi dhe, rrjedhimisht, nuk është subjekt mbikëqyrje. Në këto kushte, investitori nuk gëzon të njëjtin nivel mbrojtjeje sikurse në rastin e produkteve financiare të ofruara nga subjekte të licencuara dhe të mbikëqyrura.

Emetimi i titujve, si mënyrë për të rritur burimet e financimit për biznesin, qoftë nëpërmjet ofertës fillestare publike, IPO apo ofertës private rregullohet nga Ligji nr.9879, datë 21.2.2008 “Për Titujt”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tërheq vëmendjen e investitorëve që mund të investojnë në ICO jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për rreziqet e mundshme që mund të mbartë investimi në një ICO.

Pse duhet të bëni kujdes në lidhje me investimet në monedhat virtuale me ofertë fillestare (ICO)

- Investimi në një monedhë virtuale me ofertë fillestare, ICO mund të rezultojë si investim në një skemë mashtruese dhe si e tillë ju mund të humbisni të gjitha paratë;
- Firmat të cilat po emetojnë aktualisht Monedha Virtuale me Ofertë Fillestare, ICO janë kryesisht firma që sapo kanë filluar biznesin e tyre (*Startups*) dhe si të tilla mund të rezultojnë të pasuksesshme;
- Investimi ka rrezik të lartë likuiditeti, pasi investitorët që blejnë monedhën “Token” mund të mos kenë mundësi ta shesin atë në rast se do të kenë nevojë për para;
- Monedhat “Token” të blera nëpërmjet ICO kanë luhatje të forta të çmimit;

- Emetimet e monedhave virtuale me ofertë fillestare mund të shërbejnë si skema për të pastruar paratë dhe si të tilla investitorët mund të përballen me rrezik të konsiderueshëm ligjor;
- Investimi lidhet me një mungesë transparence si rezultat i një informacioni të pamjaftueshëm dhe të pa audituar nga shoqëritë e auditimit;
- Tregu i monedhave Virtuale me Ofertë Fillestare (ICO) mund të jetë i manipuluar, duke qenë subjekt i përhapjes së lajmeve të rreme, me qëllim për të ndikuar çmimin e monedhës virtuale, i cili mund të manipulohet lehtë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informon investitorin se në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston asnjë kompani e licencuar nga Autoriteti për të emetuar monedha virtuale me ofertë fillestare. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që mund të ekzistojnë skema mashtruese që të tërheqin investitorët për të investuar në ICO jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në të tilla raste duhet të tregoheni të kujdesshëm, pasi Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk ka licencuar asnjë agjent për të promovuar aktivitete të tilla.

Zhvillohet Konferenca e 24-të Vjetore e IAIS me temë “Mbikëqyrja në sigurime: vështrim më i gjerë”



Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtorë Ekzekutive e AMF-së në Konferencën e 24-të Vjetore "Mbikëqyrja në sigurime: vështrim më i gjerë"

Znj. Mimoza Kaçi,
Nëndrejtorë Ekzekutive e
AMF-së prezantoi
iniciativat e ndërmarra nga
Autoriteti për të rritur
edukimin financiar në
vend në kuadër të
Strategjisë së miratuar
nga Bordi i Autoritetit për
të rritur besimin e
konsumatorëve në tregjet
nën mbikëqyrje.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi në datat 2-3 nëntor 2017 Konferencën e 24-të Vjetore, të paraprirë nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve dhe mbledhjet e Komiteteve. Sekretari i Përgjithshëm i IAIS Jonathan Dixon e cilësoi këtë konferencë si "... një javë e jashtëzakonshme e arritjeve, nga marrëveshjet kyçe mbi standardet e kapitalit të grupeve dhe ndërtimin e kapaciteteve në shërbimet aktuariale, miratimin e rishikimeve të Parimeve Themelore të Sigurimit dhe miratimin e një letre të re mbikëqyrëse, së bashku me diskutime të fuqishme dhe të angazhuara në panel për tema të ardhshme."

Në përputhje me temën e konferencës, panelistët shqyrtuan të ardhmen e IAIS-it dhe peizazhin mbikëqyrës global, edukimin financiar për konsumatorët e sigurimeve, modelet e biznesit të sigurvearit, strategjitë e shpërndarjes dhe

rritjen e aksesit në sigurimeve.

Në panelin e datës 2 nëntor me titull “Duke shikuar përtej mënyrave tradicionale: promovimi i edukimit financiar për konsumatorët në sigurime” prezantoi edhe Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoe Ekzekutive e AMF-së. Znj. Kaçi prezantoi iniciativat e ndërmarra nga Autoriteti për të rritur edukimin financiar në vend në kuadër të Strategjisë së miratuar nga Bordi i Autoritetit për të rritur besimin e konsumatorëve në tregjet nën mbikëqyrje.

Në takimet që i paraprinë Konferencës Vjetore, Komiteti Ekzekutiv i IAIS miratoi një dokument për zbatim mbi Qeverisjen e Korporative të Grupeve. Në Asamblenë e Përgjithshme, u miratuan edhe rishikimet në Parimet Themelore të Sigurimit 13 (Risigurimi dhe Forma të tjera të Transferimit të Rrezikut), 18 (Ndërmjetësit) dhe 19 (Kryerja e Bizneseve).

Kolegji i Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA i Autoritetit Austriak të Tregut Financiar zhvillon mbledhje dyditore

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar zhvilloi në datat 6-7 nëntor 2017 në Vjenë, Austri, mbledhjen dy ditore të Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA.

Mbledhja u nda në katër faza:

- Në fazën e parë u prezantuan çështjet kryesore të identifikuara dhe masat e marra në sajë të vlerësimit të rrezikut gjatë vitit të shkuar, përfshi këtu rezultate të analizës së vetëvlerësimit (ORSA), rezultate të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi UNIQA Group nga EIOPA, si dhe një përmbledhje të aktiviteteve kryesore “on-site” dhe “off-site” gjatë vitit 2016;
- Në fazën e dytë përfaqësues të Autoriteteve pjesëmarrëse prezantuan çështjet kryesore dhe zhvillimet e tregut gjatë vitit 2016 dhe nëntëmujorit të 2017, si dhe mbi specifikat dhe risqet kryesore të Grupit UNIQA në vendet e tyre;
- Në fazën e tretë përfaqësues të lartë të UNIQA-s prezantuan të dhënat financiare për vitin 2016, dhe nëntëmujorin e vitit 2017; masat strategjike në nivel grupi dhe nivel individual bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit (ORSA) të grupit, si dhe të strategjinë e investimeve në sisteme të TI-së;
- Në fazën e katërt Autoriteti Austriak i Tregut Financiar prezantoi mënyrën, afatet dhe çështjet që do të trajtohen në kolegjin e ardhshëm.

Së fundi, të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga kolegji për t'u ndarë me Grupin UNIQA.

Çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga kolegji për tu ndarë me Grupin UNIQA.

Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Formimi Profesional Financiar – e tashmja dhe e ardhmja”

Instituti i Studimeve Financiare, zhvilloi në 16 nëntor, në Bukuresht, Rumani konferencën ndërkombëtare me temë: “Formimi Profesional Financiar - e tashmja dhe e ardhmja”. Konferenca trajtoi temën e profesionistëve që punojnë ose synojnë të punojnë në fushën e shërbimeve financiare.

Viti 2018 do të sjellë ndryshime të rëndësishme operacionale në industrinë e shërbimeve financiare dhe sidomos për aktorët e tregjeve financiare, si rezultat i afatit përfundimtar të zbatimit të një tërësie të Direktivave Evropiane, të cilat do të transpozohen në legjislacionin kombëtar (ligjet, aktet nënligjore, procedura, raporte, etj.) të vendeve anëtare të BE-së. Këto përfshijnë dispozita të tilla si: Direktiva e Ndërmjetësimit në Sigurime (IDD-2016/97/BE), Instrumentet Financiare (MiFID II - 2004/39 / EC), Dispozitat për Mbrojtjen e Konsumatorit, të cilat çuan në krijimin e disa rregulloreve për produktet e sigurimit me komponentë investimi brenda (PRIIP - Rregullorja (BE) Nr. 1286/2014). Gjithashtu, Rregullorja e Përgjithshme mbi Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR - Rregullorja nr. 2016/679), e zbatueshme duke filluar nga data 25 maj 2018, do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në këtë fushë.

Konferenca Ndërkombëtare e organizuar nga Instituti i Studimeve Financiare kishte disa panele me përfaqësues nga institucionet rregullatore, shoqata profesionale, shoqëri të ndryshme në tregjet financiare dhe disa institute të ngjashme të trajnimit profesional nga EU, duke u fokusuar në praktikat më të mira në industrinë e shërbimeve financiare. Gjithashtu gjatë këtij aktiviteti u diskutuan tema me interes, si:

- Implikimet e Direktivave Evropiane mbi trajnimin;
- Zhvillimi profesional në shërbimet financiare;
- Edukimi financiar në qendër të konsumatorit;
- Ndryshimet teknologjike në procesin e trajnimit;
- Njohja e certifikatave ndërkombëtare;
- Etika dhe integriteti.

Në përfundim të konferencës u mundësua dhënia e çmimit "Artikulli më i mirë shkencor" i botuar në Revistën e Studimeve Financiare.

Workshop “Mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”

Në datat 22-25 nëntor 2017 në Vjenë, u zhvillua *workshop*-i i pestë ekzekutiv për rregullatorët e tregjeve financiare “Mbi Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF” me pjesëmarrjen e mbikëqyrësve nga Evropa Lindore dhe Azia Qendrore. Organizatorë të këtij *workshop*-i ishin Qendra e Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar dhe Fondacioni i SNRF-ve.

Konferenca Ndërkombëtare kishte disa panele me përfaqësues nga institucionet rregullatore, shoqata profesionale, shoqëri të ndryshme në tregjet financiare dhe disa institute të ngjashme të trajnimit profesional nga EU, duke u fokusuar në praktikat më të mira në industrinë e shërbimeve financiare.

Workshop-i kishte si qëllim t'u jepte rregullatorëve mjetet e nevojshme për të kryer me efektivitet detyrat e tyre mbikëqyrëse në tregun bankar dhe atë të sigurimeve. Këtë vit ky *workshop* kishte një fokus të veçantë në SNRF 9, standardin kontabël "Instrumentet financiarë", i cili do të jetë i zbatueshëm nga 1 janari 2018, së bashku me SNRF 15 "Mbi të ardhurat".

Fondacioni i SNRF-ve gjithashtu prezantoi edhe SNRF 17, standardin e ri mbi kontratat e sigurimeve, për të cilat duhet të përgatiten kompanitë e sigurimeve dhe që do të jetë i zbatueshëm nga 1 janari 2021.

Temat kryesore që u trajtuan në *workshop* kishin të bënin me:

- Përpyjekjet për bashkëpunim midis rregullatorëve dhe shoqërive të auditimit për zbatimin e SNRF 9, duke sjellë eksperiencën e Bankës Qendrore të Holandës në këtë drejtim;
- Rolin dhe sfidat me të cilat përballen auditorët në aplikimin e SNRF-ve si rezultat i materialitetit dhe vlerës së drejtë (*fair value*), shoqëruar edhe me raste studimore, disa prej të cilave ishin subjekt i veprimeve aktuale rregullatore;
- Rishikimin e kërkesave të SNRF 13 dhe diskutimi mbi reagimet aktuale pas zbatimit të saj;
- Klasifikimin dhe matjen e aseteve financiare në tregun bankar, si të identifikohet një rritje e konsiderueshme e riskut të kreditit sipas SNRF 9 dhe pasojat e saj;
- Kuptimin e elementëve kyç të SNRF 17 për tregun e sigurimeve. Identifikimi i fushave kryesore për të kuptuar ndryshimet midis SNRF 17 dhe *Solvency II*. Sfidat kryesore në zbatimin e SNRF 17 dhe *Solvency II*, kuptimi më i mirë i diferencave midis raportimit financiar dhe kërkesave të kujdesshme të rregullatorëve.

Temat e mësipërme u prezantuan nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare si anëtarë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), konsulentë të Qendrës së Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar (CFRR), të Fondacionit të SNRF-ve, FMA Austria dhe Bankës Kombëtare të Holandës.

Kolegji i Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group zhvillon mbledhje dyditore

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar zhvilloi në datat 24-25 në Vjenë, Austri, mbledhjen dyditore të Kolegjit të mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group.

Mbledhja u nda në katër faza:

- Faza e parë konsistoi në prezantimin e çështjeve kryesore të identifikuara dhe masave të marra në sajë të vlerësimit të rrezikut gjatë vitit të shkuar,

Workshop-i kishte si qëllim t'u jepte rregullatorëve mjetet e nevojshme për të kryer me efektivitet detyrat e tyre mbikëqyrëse në tregun bankar dhe atë të sigurimeve.

Çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga kolegji për tu ndarë me Grupin VIG.

përfshi këtu rezultate të analizës së vetëvlerësimit (ORSA), rezultate të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi Vienna Insurance Group nga EIOPA, si dhe një përmbledhje të aktiviteteve kryesore “on-site” dhe “off-site” gjatë vitit 2016;

- Faza e dytë konsistoi në prezantimin e përfaqësuesve të Autoriteteve të çdo vendi mbi çështjet kryesore dhe zhvillimet e tregut gjatë vitit 2016 dhe nëntëmujorit të 2017, si dhe mbi specifikat dhe risqet kryesore të Grupit Vienna Insurance Group në vendet e tyre;
- Faza e tretë konsistoi në prezantimin nga përfaqësues të Bordit të Menaxhimit të të dhënave financiare për grupin për vitin 2016, dhe nëntëmujorin e vitit 2017, të masave strategjike në nivel grupi dhe nivel individual bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit (ORSA) të grupit, si dhe të strategjisë së investimeve në sisteme të TI-së;
- Faza e katërt konsistoi në një prezantim nga ana e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar lidhur me mënyrën, afatet dhe çështjet që do të trajtohen në kolegjin e ardhshëm.

Së fundi, të gjitha të çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga kolegji për t'u ndarë me Grupin VIG.

Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm

Gabriel Bernardino

Kryetar

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale, EIOPA

Konferenca e 7-të vjetore e EIOPA-s

Frankfurt, 22 nëntor 2017

Programi i konferencës së këtij viti iu dedikua temës “Sigurimet dhe pensionet nga një perspektivë e re”. Duke pasqyruar zhvillimet e kohës, z. **Gabriel Bernardino**, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale ne fjalën e hapjes theksoi se “...jetojmë në epokën e “inteligjencës artificiale” ku shkenca kompjuterike zhvillon “agjentë inteligjentë”, që do të thotë se kemi pajisje që e perceptojnë mjedisin e saj dhe ndërmarrin veprime që maksimizojnë shanset e saj për sukses për disa qëllime. Pra, si qenie njerëzore, duhet të jemi të aftë të “rifreskojmë” idetë tona, të “rishikojmë” rrugën tonë dhe të perceptojmë mjedisin tonë në mënyrë që të ndërmarrim veprime që maksimizojnë mundësinë tonë për ndërtimin e një tregu të suksesshëm sigurimesh dhe pensionesh për të mirën e shoqërisë sonë dhe qytetarëve tanë”. Konferenca kishte tre panele të cilat do të prekin gëshjte si:

- Konvergjenca Mbikëqyrëse: Duke hedhur një shikim pas, për të parë përpara;
- Si mund të funksionojë më së miri Produkti i Pensioneve Personale Panevropiane (PEPP) për qytetarët evropianë?;
- Si mund të lehtësojë ky rregullim inovacionin?

Në fjalën e tij z. **Gabriel Bernardino** preku katër tema që përfshijnë prioritetet kryesore strategjike të EIOPA-s:

1) Ruajtja e rregulloreve të konsoliduara në një mjedis në zhvillim; 2) Konvergjenca mbikëqyrëse dhe ndërtimi i një kulture të përbashkët mbikëqyrëse evropiane; 3) Fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorit në një epokë dixhitale, dhe 4) Ruajtja e stabilitetit në një botë të pasigurt.

(Marrë me shkurtime e redaktime – pjesa e parë)

Ruajtja e rregullave të konsoliduara në një mjedis në zhvillim

Zbatimi i *Solvency II* ishte një sukses për stabilitetin e sistemit financiar të Bashkimit Evropian. Në një mjedis shumë të vështirë makroekonomik me norma interesi historikisht të ulëta dhe lehtësime të pavërejtura më parë nga bankat qendrore, zbatimi i *Solvency II* u zhvillua pa probleme, për shkak të përgatitjes në kohë, qasjeve proporcionale dhe periudhave kalimtare të përshtatshme. Kjo është me rëndësi të madhe, pasi po flasim për një industri që investon më shumë se 11 trilionë euro asete.

Në përgjithësi, sektori i sigurimeve të Bashkimit Evropian është kapitalizuar në mënyrën e duhur. Periudhat specifike të tranzicionit shfrytëzohen kryesisht nga kompanitë e sigurimit të Jetës me biznese me garanci afatgjatë. Masat kalimtare synojnë të kufizojnë prociklicitetin dhe të lehtësojnë hyrjen në regjimin e ri duke u dhënë kompanive kohë për të përshtatur dhe zbatuar reformat strukturore të nevojshme në biznesin e tyre. Unë vazhdoj të besoj se kjo “këmbëngulje transparente dhe e kufizuar” është një mënyrë e përshtatshme për të balancuar konsideratat mikro dhe makroprudenciale.

Gjithashtu, industria evropiane e sigurimeve është shumë më e fortë me *Solvency II*: Është më e fortë, sepse ajo ka kapitalin më të mirë në përputhje me

Në përgjithësi, sektori i sigurimeve të Bashkimit Evropian është kapitalizuar në mënyrën e duhur. Periudhat specifike të tranzicionit shfrytëzohen kryesisht nga kompanitë e sigurimit të Jetës me biznese me garanci afatgjatë.

Kohët e fundit, EIOPA ka këshilluar Komisionin Evropian që të miratojë llogaritjet e thjeshtuara të formulës standarde të Kërkesës për Kapitalin, Aftësinë Pagueuse (SCR) për risqe si gabimi dhe vdekshmëria dhe për të zvogëluar mbivlerësimin e ndërmarrjeve të sigurimeve për vlerësimet e jashtme të kredisë duke aplikuar llogaritjet e thjeshtuara.

risqet që drejton, sepse përdor një bazë më reale për të vlerësuar dhe zbutur risqet dhe në këtë mënyrë mund t'i çmojë më mirë ato, sepse ka përmirësuar modelet e saj të qeverisjes, me një theks krejt të ndryshëm në rolin e Bordeve, ngritjen e funksioneve kryesore dhe zbatimin e Vlerësimit vetjak të Riskut dhe Aftësisë Pagueuse (ORSA). Me *Solvency II*, ne gjithashtu kemi bazën për një industri më transparente, me modele të harmonizuara për raportimin mbikëqyrës dhe publikime të përmirësuara për publikun.

Biznesi i sigurimeve është kompleks: në fushën e tij të risqeve, në bashkëveprimin e tij me tregjet financiare, në marrëdhëniet kontraktuale me mbajtësit e policave. Nuk merr asgjë pa investuar ose pa bërë përpjekje. *Solvency II*, si regjim i bazuar në risk duhet të kapë në një farë mënyre kompleksitetin themelor të biznesit dhe të godasë ekuilibrin e duhur.

Dhjetë vjet pas shfaqjes së krizës financiare, jemi tashmë në një fazë të ndryshme të ciklit rregullator që ndikohet natyrshëm nga prioritetet e reja politike të rritjes së investimeve dhe zhvillimit ekonomik. Ndërsa, sipas mendimit tim, është pikërisht momenti për të vlerësuar dhe analizuar reformat e kohëve të fundit për të zbutur çdo pasojë të paqëllimshme dhe për të rritur proporcionalitetin. Kam besimin e patundur se nuk duhet të heqim dorë nga vlerat thelbësore të stabilitetit dhe mbrojtjes së konsumatorit që kryesuan në këto reforma. Nuk mund të harrojmë se axhenda rregullatore pas krizës ishte përgjigja e duhur për të rikthyer humbjen e besimit në sektorin financiar. Për të ndërtuar një investim afatgjatë të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike, kemi nevojë për një sektor sigurimi të qëndrueshëm dhe të fortë që në mënyrën e duhur çmon risqet, zbaton strategji të fuqishme për menaxhimin e riskut dhe trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë.

Pavarësisht nga fakti se sapo fillojmë të dëshmojmë përfitimet nga reformat e *Solvency II*, tashmë po analizojmë regjimin, me qëllim uljen e kompleksitetit dhe rritjen e proporcionalitetit.

Kohët e fundit, EIOPA ka këshilluar Komisionin Evropian që të miratojë llogaritjet e thjeshtuara të formulës standarde të Kërkesës për Kapitalin, Aftësinë Pagueuse (SCR) për risqe si gabimi dhe vdekshmëria dhe për të zvogëluar mbivlerësimin e ndërmarrjeve të sigurimeve për vlerësimet e jashtme të kredisë duke aplikuar llogaritjet e thjeshtuara.

Për finalizimin e fazës së dytë të këshillave tona, e planifikuar për në shkurt 2018, EIOPA u konsultua kohët e fundit në aspekte të tjera të përgjithshme të formulës standarde të SCR-së, duke kërkuar reagime të palëve të interesuara për nën-modulet kryesore si: kapaciteti absorbues i humbjes i taksave të shtyra, risqet e marrjes në sigurim të Jetës dhe Jo-Jetës, risqet e katastrofës, borxhi i paklasifikuar dhe kapitali i palistuar dhe tema të tjera të tilla si kostoja e kapitalit në llogaritjen e marzhit të riskut.

Në krijimin e informacionit dhe njohurive për të ecur drejt vitit 2021, EIOPA është e vëmendshme ndaj ndikimeve të ndryshme në treg. Sondazhi i kohëve

Për EIOPA-n, informacionet e standardizuara, të krahasueshme dhe të duhura në lidhje me PEPP-të në dispozicion duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për konsumatorët për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të mirë-informuara dhe të vetëdijshme për planet e tyre për të kursyer për pension.

të fundit për investimet tregon për një sjellje me tendencë më shumë drejt kërkesave për vlerat e yield (*search-for-yield*) të siguruesve, e cila është një reagim i natyrshëm ndaj mjedisit me norma të ulëta interesi. Rritja e ekspozimit ndaj investimeve më jolikuide dhe klasave jo-tradicionale të aseteve, si infrastruktura, përmirëson diversifikimin e aseteve, por gjithashtu kërkon aftësi të reja të menaxhimit të riskut nga shoqëritë e sigurimit dhe një mbikëqyrje më të detajuar. Në të njëjtën kohë, në përputhje me pritshmëritë tona, vrotimet e para nga ndikimi i *Solvency II* tregojnë një rritje në investimet afatgjata dhe një alokim të qëndrueshëm ndaj kapitalit.

Një tjetër pasojë e mjedisit me norma interesi të ulëta është përsheptimi i ritmit të ndryshimit në modelet e biznesit, veçanërisht në sigurimin e Jetës, me lëvizjen drejt kontratave me garanci më të ulëta dhe më fleksibël dhe në disa vende rritja e ndjeshme e produkteve të pastra që lidhen me fondet e investimit. Ndërkohë që ky është një reagim i natyrshëm i menaxhimit për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të angazhimeve të siguruesve dhe për të optimizuar kapitalin në një mjedis të *Solvency II*, ai gjithashtu rrit transferimin e risqeve tek mbajtësit e policave. Unë besoj se ky evolucion i fundit meriton reflektim të mëtejshëm nga një këndvështrim rregullator.

Duhet të shfrytëzojmë zhvillimin e PEPP dhe rishikimin e 2021 *Solvency II* për të analizuar plotësisht provat e reja të disponueshme mbi risqet dhe karakteristikat e produkteve afatgjata të sigurimit të Jetës. Kjo veçanërisht në lidhje me karakteristikat e jo-likuiditetit të detyrimeve dhe aftësisë përkatëse të siguruesve për zbutjen e paqëndrueshmërisë afatshkurtër duke mbajtur asetet gjatë gjithë kohëzgjatjes së angazhimeve, madje edhe në kohën e tensioneve në treg.

... Duke u kthyer pas në axhendën e shërbimeve financiare evropiane, një projekt i rëndësishëm është zhvillimi i Unionit të Tregjeve të Kapitalit dhe, në veçanti, rregullorja e propozuar për Produktet e Pensioneve Personale Panevropiane PEPP. Propozimi i Komisionit Evropian bazohet në këshillën e EIOPA-s dhe është një hap i guximshëm drejt krijimit të një opsioni evropian afatgjatë për kursimet për pension: i sigurt, transparent dhe me kosto efikase, i cili do t'u ofrojë brezave të rinj të shtetasve evropianë një kuadër krejtësisht të ri të pensioneve personale për të kursyer të ardhura pensioni të mjaftueshme në të ardhmen. Jam i bindur se ligjvënësit, si në Parlamentin Evropian dhe në Këshill, do të njohin rëndësinë strategjike të kësaj iniciative për shtetasit e BE-së dhe do të kontribuojnë edhe për ta përmirësuar atë dhe për të ofruar një produkt të suksesshëm.

Mandati i EIOPA-s për të nxitur konvergencën mbikëqyrëse është me rëndësi të madhe për besimin dhe besueshmërinë tek PEPP. Sipas këndvështrimit tim, një koordinim më i fuqishëm përmes zhvillimit të planeve mbikëqyrëse për PEPP-të është i nevojshëm për të mbështetur iniciativën e një produkti të vërtetë panevropian. Për të fuqizuar transparencën e mbikëqyrjes së PEPP-ve ndaj konsumatorëve të BE-së, unë do të propozoja që EIOPA të mandatohej për të publikuar një raport vjetor mbi aktivitetet e mbikëqyrjes së PEPP-it të

—○○○—
Nga pikëpamja e mjedisit aktual ekonomik dhe sfidave me të cilat ballafaqohen produktet me detyrime afatgjata, hartimi i opsionit të investimit të parazgjedhur do të përcaktojë, në një masë të konsiderueshme, suksesin e PEPP-së.

—○○○—

kryera në të gjithë Evropën.

Për EIOPA-n, informacionet e standardizuara, të krahasueshme dhe të duhura në lidhje me PEPP-të në dispozicion duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme për konsumatorët për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të mirë-informuara dhe të vetëdijshme për planet e tyre për të kursyer për pension.

Informacionet rreth PEPP-ve duhet të jenë të përshtatshme. Prandaj, nevojitet një zhvillim i mëtejshëm i komunikimeve të favorshme për konsumatorët, që lidhen me pensionet, për deklaratat para-kontraktuale dhe përfitimet e rregullta. EIOPA mirëpret nismën e Komisionit Evropian për të mbledhur, analizuar dhe raportuar mbi treguesit e kostos dhe të performancës të investimeve kryesore afatgjata dhe të produkteve personale dhe të pensionit. Rezultatet e kësaj nisme do të përmirësojnë kërkesat e propozuara për dhënien e informacioneve për PEPP.

Nga pikëpamja e mjedisit aktual ekonomik dhe sfidave me të cilat ballafaqohen produktet me detyrime afatgjata, hartimi i opsionit të investimit të parazgjedhur do të përcaktojë, në një masë të konsiderueshme, suksesin e PEPP-së.

Për më tepër, është e rëndësishme lidhja konceptuale shumë e nevojshme ndërmjet fazës së akumulimit të PEPP-së (fazës së kursimit) dhe fazës së dekulimit (faza kur merren të ardhurat e daljes në pension). Rezultati më i rëndësishëm që llogaritet është rezultati i duhur i marrjes së të ardhurave të përshtatshme të daljes në pension për konsumatorin.

Duke marrë parasysh të gjitha këto elemente dhe për të siguruar që PEPP është me të vërtetë një produkt pensioni, se ekziston një mbrojtje e përshtatshme e kursimtarëve dhe se ata do të përfitojnë nga strategjitë e investimeve afatgjata të suksesshme, është pikëpamja ime personale se opsioni i parazgjedhur duhet të përfshijë një kërkesë që të gjitha kontributet e paguara duhet të garantohen vetëm në pikën e shpërndarjes dhe të specifikojnë konvertimin e parazgjedhur të një pjese të rëndësishme të shumës së akumuluar në tërheqje ose anuitete të programuara, duke mbrojtur kursimet nga rreziku i jetëgjatësisë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Estoni

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Estoni gjeneroi 315 milionë euro të ardhura në fund të shtatorit të këtij viti, me një rritje prej 10.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Totali i të ardhurave për segmentin Jetë llogaritet në 64.5 milionë euro, me një rritje prej 7.1% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa segmenti i Jo-Jetës gjeneroi 250.7 milionë euro të ardhura, me një rritje prej 11.5%.

Kosovë

www.xprimm.com

Kompanitë e sigurimeve në Kosovë gjeneruan fitime në vlerën 3.2 milionë euro për 9 muajt e parë të vitit, ndërkohë që të njëjtën periudhë të vitit të kaluar e kishin mbyllur me humbje në vlerën 12.1 milionë euro. Primet e shkruara bruto gjeneruan 65.9 milionë euro të ardhura deri në fund të shtatorit, duke sjellë kështu një rritje me 2.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e të ardhurave erdhën nga tregu i Jo-Jetës në masën 64 milionë euro, ndërsa segmenti i Jetës ka sjellë vetëm 1.9 milionë euro të ardhura. Gjithashtu, nga të dhënat e raportuara nga Banka Qendrore e Kosovës konstatohet një rritje e pagesës për dëmet në masën 32.4 milionë euro, nga 26.4 milionë të paguara vitin e kaluar.

Kroaci

www.xprimm.com

Siguruesit kroatë raportuan të ardhura në masën 6.9 miliardë Kuna (HRK, monedha lokale), ose rreth 922 milionë euro për 9 muajt e parë të këtij viti, me një rritje prej 2.6%, bazuar në të dhënat e Byrosë Kroate të Sigurimeve, CIB. Segmenti i Jo-Jetës u rrit me 3.3%, duke gjeneruar të ardhura prej 4.7 miliardë Kuna, ndërsa tregu i Jetës solli 2.2 miliardë Kuna të ardhura, me rritje 0.9%. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara për 9-mujorin ishte 3.6 miliardë Kuna, me një rritje prej 5.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Lituani

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të raportuara nga Banka e Lituanisë, tregu i sigurimeve në këtë shtet shënoi rritje në vlerë absolute me 82 milionë euro për një total prej 580 milionë euro në fund të shtatorit të këtij viti. Segmenti i Jo-Jetës u rrit me 20.5%, duke gjeneruar 415 milionë euro, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës u rrit me 7.6%, me të ardhura 165 milionë euro. Në vlerë absolute, segmenti i Jetës dhe dy klasat motorrike (MTPL dhe Kasko) shënuan rritjen më të madhe: 11.6 milionë euro (Jeta), 40.5 milionë (MTPL) dhe 15.7 milionë euro (Kasko).

Rusi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Siguruesve të Rusisë (ARIA), bazuar në informacionet e marra nga 5 siguruesit më të mëdhenj, gjatë 9-mujorit të këtij viti u shënuar një rritje e konsiderueshme e sigurimit të pronës. Numri i marrëveshjeve të nënshkruara për këtë lloj sigurimi u rrit me 30% me një vlerë totale rreth 20 milionë Rubla (RUB, monedha lokale), ndërkohë që tarifa mesatare e primit gjithashtu shënoi një rritje të lehtë.

Turqi

www.xprimm.com

Mbulimi i realizuar nga kompania shtetërore për sigurimet në bujqësi në Turqi është rritur në masën 20%, nga 0.5% që ishte përpara krijimit të kësaj strukture në vitin 2005. Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë theksoi se vlera totale e aseteve të marra në sigurim vlerësohet të jetë 26 miliardë Lira (TRY, monedha lokale), ose rreth 6.7 miliardë dollarë, ndërkohë që hapësira e siguruar është 200,000 hektarë. Sipas të dhënave, të ardhurat nga primet parashikohet të arrijnë deri në 1.6 miliardë Lira gjatë këtij viti, ndërsa vlera e kompensimit që do t'i paguhet fermerëve llogaritet në 850 milionë Lira.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al